

-36-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

---

**V E N D I M**

Nr. 2 Dt. 05.09.2012

**“ PER**  
**MIRATIMIN E KONTRATES TIP KONCESIONI PER**  
**PERDORIMIN E UJIT PER FURNIZIMIN ME UJE TE PIJSHEM TE POPULLATES**  
**PER**  
**320 L/sek., TE LIDHUR E NENSHKRUAR NGA DREJTUESI I A.U.B. DRIN-BUNE**  
**DHE PERFAQESUESI I NDERMARJES UJESJELLES KANALIZIME SHKODER ”.**

Ne mbeshtetje te nenit nr. 8 dhe nr. 16, te ligjit nr. 8093 dt. 21.03.1996 “Per rezervat ujore “, te germes a, te pikes 17 dhe pikes 19, te V.K.M. nr. 289 dt. 15.04.2005, “Per percaktimin e kerkesave dhe te procedurave per miratimin e lejeve, te autorizimeve dhe te koncesioneve per perdorimin e ujit” dhe te pikes 1, te vendimit nr. 2, dt. 03.03.2005 te K.K.U.-se “Per miratimin e Kontrates Tip te Koncesionit, ndermjet autoriteteve te ujit dhe sh.a Ujesjelles Kanalizimeve Malesi e Madhe, per perdorimin me koncesion te ujit, me propozimin e A.U.B.-se Drin-Bune Shkoder, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune Shkoder

**V E N D O S I :**

**1 -** Miratimin e Kontrates Tip te Koncesionit, per perdorimin e ujit te burimeve te Pellgut Ujembajtes Dobrac, te lidhur e nenshkruar me daten 28.06.2012 nga drejtuesi i A.U.B. Drin-Bune dhe perfaqesuesi i Ndermarjes Ujesjelles Kanalizime Shkoder , per sasine e ujit 320 L/sek., burimet e te cilit do te perdoren per furnizimin me uje te pijshem te qytetit Shkoder. Burimi ujore Pellgu ujembledhes Dobrac ka nje prurje mesatare mbi 1000 l/sek.

**2 -** Kjo kontrate eshte e vlefeshme deri me date 28.06.2017.

**3 -** Ngarkohet A.U.B. Drin- Bune per zbatimin e ketij vendimi.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**Sekretari**

**Muhamet MUÇA**



**Kryetare**

**Voltana ADEMI**